

ALBANIAN GREEN ENERGY sh.p.k
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albanian Green Energy sh.p.k (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënime shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.



Diana Ylli (Golemi)
Auditues Ligjor

 MAZARS 30 qershor 2017

Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone +355 42 27 80 15
www.mazars.al | info@mazars.al

Albanian Green Energy sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2016**

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	17,206,797	14,838,359
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	51,322,218	68,602,361
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		-	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	3,422,822	4,394,343
Inventarë	7	20,040	149,396
Shpenzime të shtyra	8	148,469	95,467
Total aktive afatshkurtra		72,120,346	88,079,926
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata material	9	174,629,570	168,813,058
Aktive afatgjata jomateriale	9	604,500	838,500
Total aktive afatgjata		175,234,070	169,651,558
Total aktive		247,354,416	257,731,484
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	10	-	2,844,232
Llogari të pagueshme tregtare	11	32,090,630	35,680,654
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	32,511,762	29,722,193
Detyrime tatimore	13	4,920,255	6,745,848
Të tjera detyrime	14	7,489,838	9,634,637
Total detyrime afatshkurtra		77,012,485	84,627,564
Detyrime afatgjata			
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	-	1,970,501
Total detyrime afatgjata		-	1,970,501
Totali i detyrimeve		77,012,485	86,598,065
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	16	100,000,000	100,000,000
Rezerva ligjore		9,139,485	7,198,196
Rezerva të tjera		38,993,934	25,109,442
Fitimi i ushtrimit		22,208,512	38,825,781
Total kapitali		170,341,931	171,133,419
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		247,354,416	257,731,484

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBANIAN GREEN ENERGY SH.p.k.
EDLIRA KEZAK
Rr.A. Topçani, Torle Drin, Ap.61
TIRANE



Albanian Green Energy sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	17	227,087,419	244,970,516
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	18	203,587	(515,627)
Lënda e pare, materiale të konsumueshme dhe shërbime		(128,030,313)	(117,933,540)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera	19	(114,251,427)	(104,997,790)
Të tjera shpenzime	20	(13,778,886)	(12,935,750)
Shpenzime të personelit	21	(52,965,338)	(57,240,099)
Paga dhe shpërblime		(47,980,991)	(52,239,643)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore /shëndetësore		(4,984,347)	(5,000,456)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(18,030,227)	(19,596,878)
Provizione dhe zhvleresime	22	(995,387)	-
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	23	(2,722)	(350,047)
Shpenzime financiare	24	(568,226)	(3,202,698)
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(568,226)	(3,198,738)
Shpenzime të tjera financiare		-	(3,960)
Fitimi/humbja para tatimit		26,698,793	46,131,627
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	25	(4,490,281)	(7,305,846)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(4,490,281)	(7,300,841)
Zbritje nga fitimet e viteve të kaluara			(5,005)
Fitimi/humbja e vitit		22,208,512	38,825,781
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse		22,208,512	38,825,781

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare .

EDLIRA PREZA
ALBANIAN GREEN ENERGY Sh.p.k.
Rr.A.Toptani, Torre Drin, Ap.61
TIRANE

Albanian Green Energy sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)*

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Statutore dhe Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2015	100,000,000	5,000,000	23,343,722	43,963,916	172,307,638
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin				38,825,781	38,825,781
Transferimi i fitimit të vitit në rezerva		2,198,196	41,765,720	(43,963,916)	-
Dividendë të paguar			(40,000,000)		(40,000,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000,000	7,198,196	25,109,442	38,825,781	171,133,419
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin				22,208,512	22,208,512
Transferimi i fitimit të vitit në rezerva		1,941,289	36,884,492	(38,825,781)	-
Dividendë të paguar			(23,000,000)		(23,000,000)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000,000	9,139,485	38,993,934	22,208,512	170,341,931

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Albanian Green Energy sh.p.k më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.

EDLIRA PREZA

Edlira Preza
ALBANIAN GREEN ENERGY SH.p.k.
Administrator

Rr.A.Toptani, Torre Drin, Ap. 6
TIRANE

Financiere

Albanian Green Energy sh.p.k
(Vlerat janë në Lek)
**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	22,208,512	38,825,781
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	47,363	28,779
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		315,259
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	18,030,227	19,596,878
AAM të dala nga përdorimi		
<i>Ndryshimet në aktivitet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	18,198,662	120,753,752
Rënie/(rritje) në inventarë	129,356	140,204
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(4,261,982)	(47,408,398)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	54,352,138	132,252,255
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(23,612,739)	(46,031,387)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(23,612,739)	(46,031,387)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë / Hua të arketuara		
Pagesa e huave	(4,814,733)	(82,285,722)
Interes i paguar	(538,546)	(3,178,866)
Dividendë të paguar	(23,000,000)	(40,000,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(28,353,279)	(125,464,588)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,386,120	(39,243,720)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	14,838,359	54,087,026
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(17,682)	(4,947)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	17,206,797	14,838,359

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faja 7 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBANIAN GREEN ENERGY Sh.p.k.
 Rr.A. Topitani, Torje Drin, Ap. 01
 TIRANE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është krijuar më 27/12/2006.
Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008, "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Albanian Green Energy Shpk është shoqëri shqiptare me ortak Essegei SpA shoqëri e së drejtës italiane që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 Lek. Administrator i shoqërisë nga data 23/05/2011 deri më 31/12/2016 ka qene emëruar Z.Federico Romano, nga data 01/01/2017 eshte emeruar Znj. Edlira Preza.

Selia e shoqërisë ndodhet në Njësinë Bashkiake Nr.2, Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Ap.61. Tiranë. Shoqëria është regjistruar në organet tatimore të rrethit Tiranë me NIPT K71624027U.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është prodhimi i energjisë elektrike.

Në 31 dhjetor 2016 shoqëria ka 39 punonjës (2015: 39)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të citat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2016	2015
Euro/LEK	135.23	137.28
USD/ LEK	128.17	125.79

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e AAM-ve	Norma e Amortizimit në %
Ndërtimore	5
Makineri e Pajisje	20
Mjete transporti	20
Pajisje zyre	20
Pajisje kompjuterike	25
Të tjera	20

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 është 15% (2015: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Mjete monetare në bankë	16,693,414	14,638,369
Llogari rrjedhëse	16,693,414	14,638,369
Mjete monetare në arkë	513,383	199,990
	<u>17,206,797</u>	<u>14,838,359</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
OSHEE/KESH për fatura të pranuar	23,651,203	42,817,116
OSHEE/KESH për fatura në proces certifikimi	27,671,015	25,785,245
	<u>51,322,218</u>	<u>68,602,361</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 Dhjetor 2015</u>
Paradhënie për personelin	92,117	199,239
Tatim mbi fitimin i mbipaguar	3,262,227	2,601,114
Shteti - TVSH e zbritshme	-	1,525,616
Detyrim doganor i mbipaguar	1,278	1,174
Garanci të ndryshme	67,200	67,200
Pagesat te kryera ne lidhje me ceshtjen gjyqesore me Sigal UGA	995,387	-
Zhvleresim i pagesave te kryera ne lidhje me ceshtjen gjyqesore me Sigal UGA	(995,387)	-
	<u>3,422,822</u>	<u>4,394,343</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

7. Inventarë

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Lëndë djegëse	20,040	149,396
	<u>20,040</u>	<u>149,396</u>

8. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime të shtyra	148,469	95,467
	<u>148,469</u>	<u>95,467</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Automjete	Të tjera	Në proces	Totali AAM	AAJM
<i>Kosto</i>							
Gjendja më 1 janar 2015	93,907,850	271,433,716	2,571,295	3,647,887	-	371,560,748	1,755,700
Shtesa	44,454,774	1,292,467	-	284,146	-	46,031,387	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	138,362,624	272,726,183	2,571,295	3,932,033	-	417,592,135	1,755,700
Shtesa	19,650,208	26,000	-	108,630	3,827,900	23,612,739	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	158,012,832	272,752,183	2,571,295	4,040,663	3,827,900	441,204,874	1,755,700
<i>Amortizimi i akumuluar</i>							
Gjendja më 1 janar 2015	24,093,365	200,937,945	1,548,990	2,850,210	-	229,430,510	668,889
Amortizimi i vitit	4,643,426	14,297,778	204,461	202,902	-	19,348,567	248,311
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	28,736,791	215,235,723	1,753,451	3,053,112	-	248,779,077	917,200
Amortizimi i vitit	5,925,624	11,499,679	163,569	207,354	-	17,796,226	234,000
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	34,662,415	226,735,402	1,917,020	3,260,466	-	266,575,303	1,151,200
<i>Vlera neto kontabël</i>							
Gjendja më 31 dhjetor 2015	109,625,833	57,490,460	817,844	878,921	-	168,813,058	838,500
Gjendja më 31 dhjetor 2016	123,350,417	46,016,781	654,275	780,197	3,827,900	174,629,570	604,500



Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

10. Huatë afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Overdrafte në LEK - Intesa San Paolo Bank of Albania	-	2,840,183
Overdrafte në LEK - Veneto Banka	-	4,049
	<u>-</u>	<u>2,844,232</u>

11. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime ndaj furnitorëve për fatura të pranuar	31,043,687	34,901,252
Detyrime ndaj furnitorëve për fatura të pambërritura	1,046,943	779,402
	<u>32,090,630</u>	<u>35,680,654</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Llogari të pagueshme tregtare ndaj paleve të lidhura	32,511,762	29,722,193
	<u>32,511,762</u>	<u>29,722,193</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrimi për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore	646,161	714,547
Detyrimi për Tatimin mbi të Ardhurat Personale	1,240,102	2,060,835
Detyrimi për Tatimin në burim	1,901,425	3,970,466
Detyrimi për TVSH-ne	1,132,567	-
	<u>4,920,255</u>	<u>6,745,848</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Detyrime për Pagën Neto	5,816,943	9,063,271
Detyrime për Taksën e Shfrytëzimit të ujit dhe të tjera	1,292,766	571,366
Detyrime për Taksën Rregullatore të E.R.E-s	380,129	-
	<u>7,489,838</u>	<u>9,634,637</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

15. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura (afatgjata)

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura (afatgjata) më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime ndaj Ortakut - Financime Essegei	-	1,970,501
	-	1,970,501

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100.000.000 LEK i zotëruar 100% nga ortaku ESSEGEI S.p.A shoqëri e së drejtës italiane më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016				31 dhjetor 2015			
	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%	Kuota	Vlera nominale	Kapitali i nënshkruar	%
ESSEGEI								
spa	100,000	1,000	100,000,000	100%	100,000	1,000	100,000,000	100%
	100,000		100,000,000	100%	100,000		100,000,000	100%

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2016 në vlerën 22,208,512 LEK (2015: 38,825,781 LEK).

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga shitja e energjise elektrike	244,006,699	244,970,516
Korrigjim i cmimit te shitjes se energjise elektrike, viti 2013	(8,710,800)	-
Korrigjim i cmimit te shitjes se energjise elektrike, viti 2014	(8,208,480)	-
	227,087,419	244,970,516

Me Vendim nr.143 date 26/12/2014 dhe nr.144 date 26/12/2014 të botuar në fletoren Zyrtare nr.215 datë 28 Janar 2015, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike ka rishikuar çmimin unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrale ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15MW përkatësisht për vitin 2013 dhe 2014 nga 7.77 Lek/kWh në 7.53 Lek për kWh.

"AREA, ndaj vendimeve te ERE -s Nr. 143 dhe Nr. 144 date 26.12.2014 per rishikimin e çmimit ka paraqitur padi me 3.02.2015 prane Gjykates Administrative te Rrethit Gjyqesor Tirane. Kjo e fundit, me vendimin Nr. 2192 date 16.02.2015 vendosi te aprovoje masen e sigurimit te padise ndaj vendimeve te ERE -s. Me 27.03.2015 çeshtja per shkak te kompetences u dergua per gjykim ne Gjykaten Administrative te Apelit e cila ushtron juridikision fillestar. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin Nr. 24 date 28.09.2015 rrezoi kerkesen e AREA -s. AREA ne date 27.10.2015 ka depozituar rekurs prane Gjykates se Larte dhe deri me sot, çeshtja pritet te merret ne shqyrtim nga Kolegji Administrativ i Gjykates se Larte".

Ne kushtet kur vendimi i Gjykates Administrative te Apelit Nr. 24 date 28.09.2015 eshte i formes se prere dhe i detyrueshem per t'u zbatuar nga palet, nga ana e KESH u kerkua ekzekutimi i ketij vendimi e per rrjedhoje u reflektuan keto ndryshime nepermjet saktesimit te cmimit te shitjes per prodhimin e vitit 2013 dhe 2014. Keto saktesime u bene efektive ne vitin 2016 dhe jane regjistruar ne pasqyrat e ketij viti ushtrimor.

Albanian Green Energy sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Shitje totale të deklaruara në FDP-të e TVSH-së	292,400,140	251,122,642
Autogarkesat	(65,312,722)	(871,246)
Penalitetet me KESH që i takojnë vitit 2014 të deklaruara në vitin 2015	-	(5,864,004)
Fitim humbje nga kursi i këmbimit të përfshira në zërin të ardhura të tjera të shfrytëzimit	203,587	67,497
Shitje të deklaruara në FDP-të që janë të ardhura në Pasqyren e Performances	227,291,005	244,454,889
Të ardhura sipas pasqyrës së performances	227,291,005	244,454,889
		<u>31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura sipas pasqyrës së performancës		227,291,005
Shtohen humbjet e kursit të këmbimit të përfshira në zërin Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		77,507
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Ftimit		227,368,512

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Të ardhura nga penalitetet me KESH	-	(583,124)
Fitim nga këmbimet valutore	281,094	170,557
Humbje nga këmbimet valutore	(77,507)	(103,060)
	203,587	(515,627)

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lek)

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme dhe shërbime

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Blerje materiale të para elektromekanike	7,768,773	7,795,698
Lëndë djegëse dhe vajra lubrifikant	2,474,798	2,615,154
Inventar i imet	519,148	635,528
Konsum i energjisë elektrike	712,067	607,652
Qera mjete transporti	1,976,472	1,976,472
Mirëmbajtje dhe riparime	23,040,132	14,076,447
Prime të sigurimit për hidrocentralin	1,997,166	1,663,054
Prime të sigurimit për personelin	75,000	64,800
Konsulencë teknike dhe administrative	23,074,660	23,457,560
Kontroll i njohurive teknike	42,000	28,600
Royalties	48,801,341	48,994,104
Shpenzime udhëtimi e dieta	224,700	244,416
Taksa ERE	380,129	388,600
Taksa e shfrytëzimit të ujit	3,165,041	2,449,705
	<u>114,251,427</u>	<u>104,997,790</u>

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime kancelarie e materiale pastrimi	301,983	254,695
Qira për zyra dhe printeri	2,260,374	2,234,832
Mirëmbajtje për zyrat - pajisjet informatike	275,385	351,051
Mirëmbajtje riparime automjetet	1,556,460	1,204,877
Prime të sigurimit për automjetet	48,030	48,060
Konsulencë ekonomike, juridike e noterizime	3,104,691	2,532,516
Kuota anëtarësimi, pjesëmarrje në panair e abonime	349,324	483,164
Shpenzime për ambjentet e përbashkëta e te tjera	318,966	330,305
Shpenzime udhëtimi/dieta	920,942	928,393
Shpenzime telefoni dhe interneti	696,896	918,878
Shpenzime bankare	537,513	606,680
Taksa vendore e të tjera	358,019	116,791
Shpenzime per sponsorizime	70,735	-
Shpenzime për pritje	1,301,840	929,560
Shpenzime restoranti	1,003,097	1,154,900
Shpenzime të tjera	674,631	841,048
	<u>13,778,886</u>	<u>12,935,750</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
 (Vlerat janë në Lek)

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime për paga dhe shpërblime	47,980,991	52,239,643
Shpenzime për sigurime shoq. e shënd.	4,984,347	5,000,456
	<u>52,965,338</u>	<u>57,240,099</u>

22. Zhvleresimi i llogarive te arketueshme

Zhvleresimi i llogarive te arketueshme detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Zhvleresim i pagesave te kryera ne lidhje me ceshtjen gjqesore me Sigal UGA	995,387	-
	<u>995,387</u>	<u>-</u>

23. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Gjopa dhe penalitete	2,722	121,991
Shpenzime të viteve të kaluara	-	228,056
	<u>2,722</u>	<u>350,047</u>

24. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>
Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme	568,226	3,198,738
Humbje nga këmbimet valutore	-	3,960
	<u>568,226</u>	<u>3,202,698</u>

Albanian Green Energy sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

(Vlerat janë në Lek)

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Fitimi para tatimit	26,698,793	46,131,627
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	3,236,415	2,540,643
Shpenzime pritje & percjellje	620,578	194,648
Provizione per ceshjte gjyqesore me Intersig UQA	995,387	0
Penalitet, gjoba e dëmshpërblime	2,722	121,991
Shpenzime të viteve të kaluara	0	228,056
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	1,617,728	1,995,948
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	29,935,208	48,672,270
Tatim fitimi @15%	4,490,281	7,300,841

25. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (vazhdim)

	<u>31 dhjetor 2016</u>	<u>31 dhjetor 2015</u>
Tatim fitimi i parapaguar me 1 janar	2,601,114	3,185,127
Parapagime gjatë vitit	5,151,394	6,716,828
Shpenzime tatim fitimi të vitit	(4,490,281)	(7,300,841)
Tatim fitimi i parapaguar /(për t'u paguar)	3,262,227	2,601,114

26. Transaksionet me palët e lidhura


Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>		<u>31 dhjetor 2015</u>	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Essegei SpA		14,466,126	-	18,062,616
CamunAlb Shpk		10,472,756	-	5,942,398
Slingofer Srl		0	-	7,687,680
Camuna Idroelettrica SpA		7,572,880	-	-
		32,511,762	-	31,692,694

Detajet e transaksioneve me palët e lidhura gjatë vitit të mbyllur me 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2016</u>		<u>31 dhjetor 2015</u>	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
Essegei SpA		65,312,722	-	66,085,304
CamunAlb Shpk		23,121,769	-	16,079,875
Slingofer Srl		0	-	7,736,400
Camuna Idroelettrica SpA		7,627,200	-	-
		96,061,691	-	89,901,579

Shpërblimi total i dhënë stafit drejtues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 është 1,531,115 LEK (2015: 4,151,424 LEK).



27. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

